



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**



Nr.1 prot.

Tepelenë, më 29.01.2026

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 29.01.2026, ora 11:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 22.12.2025.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2025”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor”.
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e planit operacional vjetor të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026 ”.
7. **Projektvendim:** “Për zhvillimin e pronës në fshatrat Salari, me numër kadastral 1094/4, 1094/5; Zona Kadastrale nr. 3252, Gusmar me numër kadastral 764, 134, 131,182, 132, Zona Kadastrale nr. 1913, Progonat me Numër Kadastral 735, 752, 717, 721, 722, 729, 728, 702, 700, 625, 630, 636, 399, 649, 659, 682, 686, Zona Kadastrale nr. 3057, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit, të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin “e-albania”.

8. **Projektvendim:** “Për zhvillimin e pronës në fshatin Dragot me numër kadastral , 392 Zona Kadastrale nr.1529, me përfitues Bashkinë Tepelenë dhe zhvillues CESVI Albania (OJF) si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit të aplikojë”.
9. **Projektvendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë”
10. **Projektvendim:** “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”.
11. **Projektvendim:** “Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë”.
12. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore”.
13. Çështje të tjera.
14. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Arben Gumeni**, drejton mbledhjen.
Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00.

Këshilltarët e pranishëm në momentin e hapjes së mbledhjes:
Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo.

Të pranishëm nga Administrata e Bashkisë:
Arta Shaha, Gëzim Shehu, Avni Abedini, Armand Sala, Festime Elezi, Pëllumb Hoxha, Aleksandër Toti.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Arben Gumeni**, përshëndet të pranishmit dhe hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin janar, duke paraqitur rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit pyet anëtarët nëse janë dakord me rendin e ditës dhe propozon hedhjen e tij në votim.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 10 (dhjetë)
Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo.

Vota KUNDËR: Nuk ka
Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e dytë e rendit të ditës Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 22.12.2025

Kryetari i Këshillit Bashkiak u drejton pyetje këshilltarëve në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Vota PRO: 10 (dhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e tretë e rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin dhjetor 2025”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, e cila informon se Komisioni është mbledhur dhe është njohur me materialin përkatës. Ajo thekson se trajtohen me ndihmë ekonomike **11 familje** dhe se nuk ka ndryshime krahasuar me muajin e kaluar, duke propozuar miratimin e projektvendimit.

Këshilltari Z. Ditar Hodaj shprehet se për familjet që nuk kanë marrë pikëzim, duhet të bëhet sqarimi përkatës dhe në mbledhjen e radhës të paraqiten emrat sipas pikëzimit, numri i përfituesve dhe renditja e tyre.

Z. Armand Sala sqaron se mosmarrja e pikëve lidhet me faktin që çdo muaj bëhen aplikime të reja. Administratorët dorëzojnë çdo muaj aplikimet, nga të cilat rezultojnë përfituesit dhe jo përfituesit. Lista e personave që nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike paraqitet në Këshill, dhe këshilltarët propozojnë emra për trajtim nga fondi 6% ose nga fondi i Bashkisë.

Kryetari i Këshillit pyet nëse ka pyetje të tjera dhe propozon hedhjen e çështjes në votim.

Vota PRO: 10 (dhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e katërt e rendit të ditës Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin dhjetor 2025”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, e cila informon se Komisioni është mbledhur dhe është njohur me materialin përkatës. Ajo thekson se trajtohen me ndihmë ekonomike 92 familje, fondi mbetet i pandryshuar krahasuar me muajin e kaluar dhe propozon miratimin e projektvendimit.

Këshilltari Z. Ditar Hodaj; Kush kryen verifikimet në terren?

Z. Armand Sala; Verifikimet kryhen nga administratorët e njësive administrative.

Këshilltari Ditar Hodaj; Në mbledhjen e radhës të paraqiten kriteret që plotësojnë përfituesit dhe informacion mbi verifikimet në terren, dhe pyetje lidhur me:

- Përfitojnë ndihmë ekonomike familjet që ndodhen jashtë shtetit?
- Ka persona që përfitojnë njëkohësisht nga fondi 6% dhe nga fondi i Bashkisë?

Kryetari i Këshillit, ka pyetje jo, propozon hedhjen e çështjes në votim.

Vota PRO: 10 (dhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e pestë e rendit të ditës; Projektvendim: “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%, ose me fondet e buxhetit vendor”

Këshilltari Vladimir Bakiaj, pjesë e mbledhjes.

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, Komisioni e ka diskutuar projektvendimin në mbledhjen e tij dhe shprehet dakord me përmbajtjen e tij, duke veçuar pikën 3 të relacionit, ku parashikohet ndarja e barabartë për çdo njësi administrative. Ajo kërkon që sqarimi të bëhet nga përfaqësuesi i administratës, z. Armand Sala.

Z. Armand Sala; Njësitë administrative më të vogla kanë pasur më pak kërkesa, ndërsa Njësia Qendër dhe Njësia Qytet kanë pasur numër më të lartë kërkesash.

Këshilltari Ditar Hodaj kërkon që të hiqet fjalia e parë e pikës 3 të relacioni dhe shprehet dakord me miratimin e tij me këtë ndryshim.

Këshilltari Vladimir Bakiaj; Ka raste kur familje që përfitojnë pagë trajtohen njëkohësisht me ndihmë ekonomike dhe kërkon që këto raste të verifikohen.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Për çdo pretendim duhet të paraqitesh raste konkrete dhe emra.

Kryetari i Këshillit deklaron se në pikën 3 të projektvendimit hiqet fjalia e parë dhe propozon hedhjen në votim të projektvendimit me këtë ndryshim.

Vota PRO: 11 (njëmbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e gjashtë e rendit të ditës; Projektvendim: “Për miratimin e planit operacional vjetor të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Këshilltari Ditar Hodaj; Në materialin e paraqitur inventarizimi në vitet 1981 dhe 1985, pse nuk është kryer inventarizim deri në vitin 2025 dhe vë në dyshim vlefshmërinë e planit operacional pa një inventarizim të përditësuar.

Z. Gëzim Shehu; Hartimi i planeve të menaxhimit dhe përditësimi i inventarit kërkon financim, pasi kanë kosto të konsiderueshme, ndërkohë që buxheti i Bashkisë është i pamjaftueshëm për realizimin e tyre në kohë. Ai thekson se për vitin aktual është planifikuar ndërhyrja për kullotat.

Z. Avni Abedini; Inventarizimet e viteve 1981 dhe 1985 janë përditësuar çdo vit deri në vitin 2013, kur funksiononin drejtoritë pyjore. Nga viti 2014 e në vijim, Bashkia Tepelenë nuk ka kryer përditësime të plota. Gjatë vitit 2025 është përditësuar një pjesë e inventarit dhe është hartuar plani i mbarështimit me investim nga Bashkia, duke u mbështetur fillimisht Njësia Administrative Kurvelesh, si një ekonomi e vogël, me qëllim krijimin e një eksperience që do të shtrihet edhe në njësitë e tjera. Ai thekson se shqetësimi është i drejtë, se po evidentohen parcelat që kanë nevojë për rivlerësim dhe se po hartohet një program për këtë qëllim. Planit operacional është një detyrim ligjor.

Znj. Matilda Çela; Cilat janë arritjet dhe mosarritjet nga plani i vitit të kaluar dhe çfarë përmirësimesh parashikohen në planin e ri, lidhur me rritjen e tarifave për marrjen me qira të kullotave, tarifat janë dyfishuar. Shqetësime lidhur me afatizimin e kontratave të qirasë, si dhe me raste kur janë dhënë me qira 3–5 ha, ndërkohë që në terren rezulton shfrytëzim deri në 20 ha, duke kërkuar që këto raste të verifikohen në terren. Nëse verifikimet nuk kryhen nga administrata, edhe anëtarët e Këshillit Bashkiak duhet të angazhohen për verifikimin e ankesave.

Nga Këshilli Bashkiak dhe Komisioni përkatës parashtrihen këto propozime:

- të ngrihet grup pune për monitorimin e dhënies me qira të pyjeve dhe kullotave;

- të zhvillohen dëgjesa publike në çdo njësi administrative ku jepen me qira pyje dhe kullota, veçanërisht në rastet kur ka konflikte;
- çdo parcelë që jepet me qira për kullotë, në rast konflikti, të shoqërohet me dëgjese publike.

Këshilltari Latif Kaçaj shprehet se çdo parcelë e dhënë me qira për kullotë duhet të kalojë në dëgjese publike kur ka konflikte, duke theksuar se ka pasur edhe raste me ndryshim parcelash, gjë që nuk lejohet, edhe për kontratat njëvjeçare, nëse ka konflikt, duhet të ketë dëgjese publike.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Kur ka konflikte, parcelat nuk duhet të jepen me qira,.

Këshilltari Vladimir Bakiaj; Lidhur me tokat me qira dhe vonesat në dhënien e lejeve për rrethim.

Z. Avni Abedini; Ligji parashikon rrethimin si kompetencë të urbanistikës.

Kryetari i Këshillit; Dëgjesat publike do të zhvillohen vetëm në rastet kur ka konflikte, ndërsa për kontratat njëvjeçare pa konflikt nuk parashikohet dëgjese.

Këshilltar Ditar Hodaj; Propozimet e Komisionit të hidhen në votim.

Kryetari i Këshillit propozon hedhjen në votim të pikës me ndryshimet e propozuara nga Komisioni, e cila miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro.

Z. Gëzim Shehu; Plani operacional për vitin 2025 është realizuar, investimet janë kryer dhe se tarifat për kullotjen janë ndryshuar në muajin korrik 2025, konkretisht:

- për **dele**: nga 10 lekë në 20 lekë për krerë;
- për **dhi**: nga 10 lekë në 25 lekë për krerë;
- për **bagëti të trasha**: nga 80 lekë në 100 lekë për krerë.

Ai thekson se janë rritur edhe tarifat për përdorime të tjera.

Afati i kontratave të qirasë është:

- sezonal, nga 6 muaj deri në 10 vjet, në përputhje me planin e mbarështimit;
- kontrolli i kontratave të qirasë kryhet çdo 6 muaj;
- për ankesat, verifikimet kryhen në bazë të informacionit nga rojet në terren ose nga kryepleqtë e fshatrave.

Aktualisht nuk ka ankesa për konflikte. Parcelat për dru zjarri janë të përcaktuara dhe çdo njësi administrative ka parcelat e saj përkatëse.

Këshilltari Ilir Haska ngre shqetësimin për rastet kur, ka konfliktesh, toka e një individi mund të jepet me qira një pale tjetër.

Z. Gëzim Shehu sqaron se toka nuk jepet me qira nëse nuk është pjesë e inventarit të Bashkise

Në lidhje me një rast konkret në fshatin Dukaj, z. Gëzim Shehu sqaron se:

- dhënia me qira e pasurisë publike parashikohet nga udhëzimi i Këshillit të Ministrave;
- procedura zhvillohet me konkurim ose shpallje, sipas rastit, dhe nuk parashikon dëgjese publike individuale;
- dëgjesa publike zhvillohet gjatë diskutimit të buxhetit të Bashkisë, ku parashikohen edhe të ardhurat nga pyjet dhe kullotat;
- për dhënien me qira afatshkurtër deri në 3 vjet, procedura zhvillohet sipas udhëzimit përkatës;
- tokat bujqësore jepen me qira deri në 99 vjet, ndërsa pyjet dhe kullotat deri në 10 vjet.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Në fshatin Dukaj bëhet fjalë për prona të trashëguara që aktualisht figurojnë pronë shtetërore, dhe nuk kemi të bëjmë me sipërfaqe të mëdha. Ai thekson se parcela e marrë me qira ndodhet brenda kullotës ekzistuese dhe se një sipërfaqe rreth 500 m² ka qenë më parë repart ushtarak.

Këshilltari Ilir Haska pyet nëse është verifikuar që parcela nuk ka pronar privat.

Kryetari i Këshillit sqaron se toka e dhënë me qira është objekt konflikti vetëm për sipërfaqen 500 m² brenda kullotës dhe se nuk është zhvilluar dëgjese publike për shkak të konfliktit, ndërkohë që dokumentacioni është i bazuar në të dhënat e Kadastrës, sipas të cilave prona rezulton pronë shtetërore.

Këshilltari Ilir Haska kërkon që të kryhet verifikim në terren, duke theksuar se pala pretenduese deklaron se ka dokumentacion pronësie.

Kryetari i Këshillit thekson se, nëse ekziston dokument që vërteton pronësi private, ai duhet të paraqitet nga pala pretenduese.

Z. Gëzim Shehu sqaron se procedura do të vijojë me konkurim, dhe çdo subjekt që ka pretendime duhet t'i drejtohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

Znj. Matilda Çela; Në rastet kur ka konflikt duhet të zhvillohet dëgjese publike dhe të ngrihet grup pune për verifikim.

Këshilltari z. Besnik Maca pjese e mbledhjes.

Kryetari i Këshillit propozon hedhjen në votim pikes së gjashte të rendit të dites.

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka
Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e shtatë e rendit të ditës; Projektvendim: “Për zhvillimin e pronës në fshatrat Salari, Gusmar dhe Progonat, sipas numrave përkatës kadastralë, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si dhe autorizimin e zhvilluesit ose përfaqësuesit të tij për të aplikuar për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse në portalin ‘e-Albania’

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Për këtë pikë fjalën e merr z. Aleksandër Toti.

Z. Aleksandër Toti; Ju jeni njohur me materialin dhe se projekti ka të bëjë me:

- rikonstrukcionin e qendrës së fshatit Progonat;
- rikonstrukcionin e qendrës së fshatit Gusmar, përfshirë edhe lapidarin;
- ndërtimin e një pike turistike për shërbime në fshatin Salari.

Ai thekson se investimi realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), është rezultat i një procesi disavjeçar dhe përfshin zonën e Labërisë, përfshirë Bashkitë Himarë dhe Tepelenë. Ai sqaron se përzgjedhja e zonave nuk është bërë nga Bashkia, por Bashkia ka përfituar nga programet e financimit për zhvillimin e këtyre qendrave. Projekti është i fituar dhe paraqitet për miratim me qëllim nxjerrjen e lejeve përkatëse, në mënyrë që investimi të nisë gjatë muajit pasardhës. Investimi nuk financohet nga buxheti i Bashkisë.

Këshilltari Ditar Hodaj pyet nëse do të priten rrepet në Progonat.

Z. Aleksandër Toti sqaron se pemët janë pasuri kombëtare dhe nuk do të priten.

Këshilltari Latif Kaçaj shprehet se projekti është lobuar nga administrata dhe kërkon që të bëhet lobim edhe për Njësinë Administrative Lopës, duke përmendur fshatrat Dhemblan dhe Matohasanaj, të cilët kanë potencial zhvillimi dhe pasuri kulturore, si kala.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Këshilli sot ka në shqyrtim këtë dokument për investim, i cili kërkon miratim për vijimin e procedurave.

Z. Aleksandër Toti; Programi për zonën e Kurveleshit përfshin territorin e Labërisë, Himarës dhe Borshit, për Njësinë Administrative Lopës ka përfunduar projekti i zbatimit për segmentin Matohasanaj–Sinanaj, ndërkohë që është në diskutim edhe aksi Sinanaj–Sevaster.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, pyet nëse ka pyetje apo diskutime të tjera dhe propozon hedhjen e projektvendimit në votim.

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka
Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e tetë e rendit të ditës Projektvendim: “Për zhvillimin e pronës në fshatin Dragot, me numër kadastral 392, Zona Kadastrale nr. 1529, me përfitues Bashkinë Tepelenë dhe zhvillues ‘CESVI Albania’ (OJF), si dhe autorizimin e zhvilluesit ose përfaqësuesit të tij për të aplikuar”

Z. Aleksandër Toti informon se projekti realizohet nga Bashkia Tepelenë në bashkëpunim me organizatën CESVI Albania, një organizatë italiane që operon në territorin e Shqipërisë dhe administron fonde të Bashkimit Evropian në kuadër të projekteve zhvillimore.

Bashkia Tepelenë është pjesë e këtij projekti, i cili parashikon ndërtimin e një stacioni rafting për aktivitete ujore në lumin Vjosë, në fshatin Dragot. Qëllimi i projektit është nxitja e turizmit dhe përfshirja e të rinjve, veçanërisht atyre që zotërojnë gjuhë të huaja.

Objekti do të ndërtohet në një parcelë të lirë, me akses si nga rruga ashtu edhe nga lumi. Investimi është relativisht i vogël në vlerë, por me perspektivë zhvillimi afatgjatë. Financimi është i siguruar dhe kërkohet mbështetja e Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave.

Kryetari i Këshillit pyet nëse ka pyetje dhe propozon hedhjen në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka
Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e nëntë e rendit të ditës “Për pranimin në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë”

Znj. Arta Shaha; Pranë Bashkisë Tepelenë është paraqitur kërkesa e shtetasit Fatmir Alira, banor i Njësisë Administrative Qytet Tepelenë, për t’u pranuar në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë për strehim.

Kërkesës i është bashkëlidhur dokumentacioni përkatës, në përputhje me **VKM nr. 518, datë 04.09.2018**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, ku përfshihen:

Dokumentacioni i paraqitur për përfitimin e shërbimit përfshin:

- certifikatë familjare;
- kartë identiteti;
- vërtetim si banor i Bashkisë Tepelenë;
- vërtetim nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore për masën e pensionit;

- raport mjekësor.

Këshilltari Ditar Hodaj; dokumentacioni nuk është i plotë, pasi mungon raporti mjekësor, dhe propozon që materiali të paraqitet në mbledhjen e radhës.

Znj. Mirela Varfi, Kryetare e Komisionit; Komisioni e ka diskutuar çështjen dhe ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të plotë, duke propozuar miratimin e kërkesës.

Kryetari i Këshillit, z. **Arben Gumeni**, propozon hedhjen e çështjes në votim.

Vota PRO: 11 (njëmbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: 1 (një) votë. Ditar Hodaj

Pika e dhjetë e rendit të ditës “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë”

Z. Pëllumb Hoxha; iSektorit të Emergjencave Civile, informon se në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, është bërë njoftimi publik në muajin nëntor 2025 për paraqitjen e kërkesave për aplikim. Për shkak të numrit të kufizuar të aplikimeve, afati është shtyrë deri më 20 dhjetor 2025, me qëllim plotësimin e dokumentacionit. Masa e qirasë, në bazë të të ardhurave familjare, mbulohet deri në 100% për familjet që kanë aplikuar dhe që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike. Rreth 90% e aplikuesve janë përfitues edhe në vitin e kaluar dhe, duke qenë se nuk ka ndryshime në statusin e tyre, kontratat noteriale vijojnë me afat **2–3 vjet**. Për këto arsye, propozohet që masa e qirasë të mbetet e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Me sigurimin e fondeve shtesë, kjo masë mund të ndryshojë.

Në total, përfitues janë 37 familje.

Znj. Mirela Varfi, Kryetare e Komisionit; Komisioni ka vendosur ta kalojë projektvendimin për miratim.

Kryetari i Këshillit pyet nëse ka pyetje dhe propozon hedhjen në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika 11 e rendit të ditës Projektvendim: “Për trajtimin me bonus strehim të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë”

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, informon se për përmirësimin e banesave do të zhvillohet një mbledhje jashtë radhe në muajin shkurt, kur materiali të jetë gati. Aktualisht, për bonus strehimi, nga 36 familje, është shtuar edhe një kërkesë, duke e çuar totalin në 37 familje. Ka pyetje para hedhjes së çështjes në votim.

Këshilltari Ditar Hodaj kërkon sqarime lidhur me verifikimin e pagesave, lidhjen e marrëveshjeve dhe dokumentacionin shtesë përveç pronësisë, duke theksuar rrezikun e mundshëm të abuzimit.

Z. Pëllumb Hoxha sqaron se përveç dokumentit që vërteton mungesën e banesës, aplikantët kanë edhe dokumente të tjera, duke përfshirë raste si vajza apo nënë me fëmijë; nuk ka kërkesa pa kontratë qiraje.

Këshilltari Ditar Hodaj propozon që marrëveshja të bëhet me akt noterial **dhe të paraqitet në mbledhjen e ardhshme.**

Pëllumb Hoxha thekson se pa akt noterial nuk mund të bëhet marrëveshja.

Këshilltarja Matilda Çela kërkon të rishikohet lista, duke përmendur se disa persona jetojnë me prindërit e tyre dhe duhet verifikuar nëse prindi ka bërë kërkesë.

Pëllumb sqaron se kërkesat i bëjnë vetë personat tek ADISA.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, propozon hedhjen e çështjes në votim për 37 familjet, me kontratat përkatëse.

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Pika e 12 e rendit të ditës; Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore”

Këshilltari Ditar Hodaj pyet për verifikimin e zjarrefikses.

Z. Pëllumb Hoxha sqaron se është vertetimi origjinal, dhe se dhënia e ndihmës financiare bazohet mbi atë dokument.

Ditar Hodaj; Sa është vlera e fondeve të akorduara?

Pëllumb Hoxha; Vlera është 125,000 lekë, e parashikuar nga preventivi dhe nga **fondi i emergjencave civile**, i miratuar për vitin 2026, sipas procesverbalit të dëmit të shkaktuar.

Këshilltari Vladimir Bakiaj shpreh shqetësim për menaxhimin e emergjencave, duke vënë në dukje se disa kërkesa të tjera për dëmshpërblim nuk kanë marrë përgjigje nga Bashkia, duke pyetur se si mund të konsiderohet kjo si emergjencë, pasi të gjithë kanë pësuar fatkeqësi natyrore.

Pëllumb Hoxha sqaron se rasti konkret për këtë projektvendim është i lidhur me **shpërthimin apo djegien e një shtëpie**, dhe për këtë arsye konsiderohet emergjencë.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, sqaron se kërkesat që nuk janë kthyer përgjigje janë aktualisht në proces dhe do të kthehet përgjigje për secilën prej tyre.

Ai propozon hedhjen në votim të **pikës 12**, lidhur me dhënien e ndihmës financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore.

Votimi u zhvillua i hapur:

Vota PRO: 12 (dymbëdhjetë)

Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Marjos Jorgo, Vladimir Bakiaj, Besnil Maça.

Vota KUNDËR: Nuk ka

Vota ABSTENIM: Nuk ka

Kryetari këshillit: Disa nga kërkesat e paraqitura në këtë mbledhje janë:

Z. Qamil Myfit Qamili, banor i Njesisë Administrative Kurvelesh, fshati Nivicë kërkon ndihmë financiare për riparimin e banesës. Kryetari sqaron se zoti duhet të aplikojë sipas procedurave për rikonstruksion banese.

Kërkesa nga disa familje në lagjen Kala, ku po zbatohet projekti i rrjetëzimit dhe përmirësimit të vlerave të kalasë. Projekti parashikon mbulim me çati, por banesat janë të vjetra dhe përbëjnë rrezik. Familjet kërkojnë ndërprerjen e zbatimit të projektit deri në gjetjen e një zgjidhjeje. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

Kërkesa nga banorët e pallatit në lagjen Demokracia, qyteti Tepelenë, për rikonstruksion dhe termoizolim të pallatit, përfshirë sistemin “kapot”. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë. (Bashkëngjitur kërkesa

Z. Alket Nora – banor i qytetit Tepelenë kërkon ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut, në tokën bujqësore (Bashkëngjitur kërkesa) Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

Z. Elvis Shehu – banor i qytetit Tepelenë kërkon ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut, në parcelën e mbjelle me pemtari (Bashkëngjitur kërkesa) Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

Znj. Feride Hysa, banore e fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër – kërkon ndihmë financiare për rikonstruksion banese. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

(Bashkëngjitur kërkesa

Z. Kujtim Kokona, banor i fshatit Hormovë, Njësia Administrative Qendër – kërkon ndihmë financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri në parcelën e mbjellë me pemtari. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë. (Bashkëngjitur kërkesa

Z. Petrit Pila, banor i fshatit Turan, Njësia Administrative Qendër – kërkon ndihmë financiare për dëmin e shkaktuar nga reshjet e shiut në pemtari. (Bashkëngjitur kërkesa) Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

Z. Artan Sunda, banor i fshatit Veliqot, Njësia Administrative Qendër – kërkon ndihmë financiare për humbjen e pelës së tij. Kjo kërkesë t'i drejtohet zyrës përkatëse të bashkisë.

Këshilltari Latif Kaçaj propozon që masa e shpërblimit të Kryetarit të Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni, nga 10%, të rritet sipas nenit 116, të rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, në masën 20%.

Këshilltarët u shprehën unanimisht pro rritjes së shpërblimit të Kryetarit të Këshillit.

Ju faleminderit,

Mbyllet mbledhja e këshillit në orën 12:47.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI

